-Marco Falcone, i lindur në Saronno (VA) më 20 janar 1976, banues në Fenegro (CO) në rrugën "Madona del Castello", nr. 5, me kod fiskal FLC MRC 76A20 I441V, shtetas italian;
-Stefano Maruzzella, i lindur në Saronno (VA) më 01 Gusht 1977, banues në Limido Comasco (Co), rruga "Giovanni Falcone", nr. 10, kodi fiskal MRZ SFN 77M01 I441J, shtetas italian.

Për identitetin e të cilëve, unë noterja u njoha dhe u sigurova,

Të cilët bien dakord dhe deklarojnë sa vijon

1) Nga zotërinjtë Marco Falcone dhe Stefano Maruzzella është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin:

"Gulliver S.R.L"

Me seli në Milano (MI).

Në përfundim të regjistrimit të shoqërisë tregtare në Regjistrin e shoqërive tregtare, adresa e selisë së shoqërisë është caktuar në rrugën Cusani nr. 8.

Transferimi i selisë brenda së njëjtës komunë, nuk sjell ndryshimin e aktit të themelimit.

2) Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar duke filluar nga sot e deri në 31(tridhjetë e një) Dhjetor 2050 (dymijë e pesëdhjetë).

3) Shoqëria ka për objekt aktivitetin e mëposhtëm:

- tregtimin, riparimin, qiradhënien, instalimin, prodhimin dhe përfaqësimin e materialit elektrik, elektronik, përçuesit elektrik, material radiofonik, informatik (komponent hardware dhe software), për telekomunikacion dhe për telefoninë celulare, për automatizimin e shtëpisë dhe për elektroshtëpiaket në përgjithësi, duke përfshirë



materialin për sektorin e sigurimit të personave dhe të gjërave dhe parandalimin e aksidenteve, panele solare dhe aparatura për kursimin e energjisë elektrike, aparatura dhe materiale të sektorit hidro dhe termosanitar.

- Magazinimin, krijimin, dhe ushtrimin e/ose menazhimin e magazinës, magazinim edhe për llogari të të tretëve të mallrave të të gjitha tipeve.

- Transportim për vete ose për llogari të të tretëve, transportime dhe transferime si edhe të gjitha operimet e lidhura me transportin e mallrave dhe të materialeve pronë private, shoqëri tregtare dhe ente publike duke përfshirë punën e hamallit, logjistikë dhe lëvizje e mallrave

- Organizimin e kurseve për formim profesional në sektorët e mësipërm (jo për qëllimin e futjes në punë, por për trajnimin e punëtorëve të cilat janë të punësuar ose për klientët).

- Aktivitetin e E-Commerce të kryer për vete dhe për llogari të të tretëve.

Të cilat janë parashikuar më së miri nga neni 4 i statutit të shoqërisë, referuar më poshtë.

4) Kapitali i shoqërisë është përcaktuar të jetë në euro 10.000,00 (dhjetë mijë) euro dhe do të derdhet i gjithë në lek nga ortakët themelues sipas përcaktimeve si më poshtë:

- Z. Marco Falcone me kuota prej 50% (pesëdhjetë për qind) të konvertuara në shumën prej 5.000,00 (pesë mijë) eurosh.

- Z. Stefano Maruzzella me kuota prej 50% (pesëdhjetë për qind) të konvertuara në shumën prej 5.000,00 (pesë mijë) eurosh.

Pranohet se prej kapitalit të sipërcituar janë derdhur 25% (njëzet e pesë përqind), të barazvlefshme me 2.500,00 euro (dymijë e pesëqind) euro në bankën Intesa San Paolo S.P.A, filiali i Turante në dt. 9 (nëntë) Janar 2012 (dymijë e dymbëdhjetë), siç rezulton dhe nga ekstrakti i depozitimit me të njëjtën shumë, të lëshuar nga banka në të njëjtën datë, e cila më dorëzohet në original nga të pranishmit.

Në lidhje me depozitimin e kapitalit të shoqërisë siç është specifikuar më lart, ortakët kanë dhënë kontributin e tyre në para të barazvlefshme me kuotat e antarësimit në kapitalin e shoqërisë.

Ortakët janë të detyruar të derdhin në arkën e shoqërisë edhe 75% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë, kontribut i cili do jetë në para, në përpjesëtim me kuotat përkatëse me anë të një kërkesë të thjeshtë të "Organit Administrativ.

5) Shoqëria konsiderohet e themeluar konform normave të përcaktuara në këtë akt themelimi si dhe të atyre të përcaktuara në statutin e shoqërisë, që pasi u lexua nga unë para palës të pranishme, është aprovuar nga të njëjtët dhe për këtë shkak i bashkangjitet këtij akti pas shkronjës A, pas firmës së palës së pranishme dhe firmës sime si notere.

6) Administrimi dhe përfaqësimi i shoqërisë i caktohet me afat të pacaktuar të 2 (dy) administratorëve, të cilët nuk bëjnë pjesë në Bordin Administrues.

- Si administratorë të parë caktohen të pranishmit z. Marco Falcone dhe Stefano Maruzzella, me të dhënat e cituara më lart, të cilët kanë të drejtën e firmës dhe të gjitha të drejtat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, përveç përjashtimeve në bazë të ligjit dhe me përjashtim të kryerjes së operacioneve të mëposhtme, të cilat kërkojnë nënshkrimin e përbashkët të të dy administratorëve:

- Blerje, shitje, shkëmbim i pasurive të paluajtshme, ose aksione në shoqëri tregtare ose në degët e tyre, themelim, ndryshim ose shuarje e të drejtave reale mbi pasuritë e përmendura;

- marrje leasing të pasurive të patundshme dhe të obligacioneve

- nënshkrimi i kontratave të financimit afatmesëm ose afatgjatë dhe të kredive

- dhënie e garancive të sendeve të paluajtshme dhe/ose personale në favor të të tretëve

- nënshkrimin e kambialeve ose të dorëzaniave.

Në lidhje me caktimin e administratorëve të mësipërm, z. Marco Falcone dhe Stefano Maruzzella, deklarojnë se e pranojnë detyrën që ju është caktuar.

7) Viti fiskal mbyllet në 31 (tridhjetë e një) Dhjetor të çdo viti.

Viti i parë fiskal do të mbyllet në 31 (tridhjetë e një) Dhjetor 2012 (dymijë e dymbëdhjetë).

8) Z. Marco Falcone deklaron se është i martuar dhe se ka regjim të ndarë pasuror dhe z. Stefano Maruzzella deklaron se është i lirë.

9) Shuma totale e shpenzimeve për themelimin e shoqërisë presumohet të jetë në shumën prej 2.500,00 euro (dymijë e pesëqind) euro dhe janë në ngarkim ekskluzivisht të shoqërisë së themeluar.

Palët deklarojnë se akti bashkangjitur përbën pjesën thelbësore të këtij akti.

Këtë akt së bashku me statutin bashkangjitur këtij akti, unë noterja e lexova në prani të palëve, të cilët e miratuan dhe e nënshkruan në orën 16.30.

Përbëhet nga dy faqe të shkruara nga persona të besuar nga unë dhe nga unë noterja, një pjesë me makinë e një pjesë me dorë me pesë faqe të plota dhe e gjashta deri këtu.

F. to Marco Falcone

Stefano Maruzzella

Alessandra Sanfelici (i.s)

Vula e lëshuar sipas dekretit 22/02/2007 Mediante M.U.I.

Kopja e përpiluar elektronikisht është e njëjtë me origjinalin e dokumentit, të përpiluar në letër, sipas parashikimeve të nenit 23 të D.Lgs. 7 Mars 2005 neni 82, që i referohet Regjistrimit të shoqërive.

Bashkangjitja "A" me nr. 8024/3715 Rep

Statuti

Emërtimi, Selia, Objekti, dhe Kohëzgjatja

Neni 1

Emërtimi

Themelohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin:

"Gulliver S.R.L."

Neni 2

Selia

Shoqëria e ka selinë në komunën e Milanos (MI).

Shoqëria ka të drejtë të hapi dhe të mbylli seli dytësore ose degë, zyra, magazina si në Itali ashtu edhe jashtë vendit.

Neni 3

Adresa e ortakëve dhe e organeve të shoqërisë

Adresa e ortakëve, administratorëve, e anëtarëve dhe audituesit financiar, nëse janë emëruar, është ajo që rezulton e regjistruar në Regjistrin e shoqërive tregtare, por nëse ndryshohet adresa, duhet të komunikohet me shkrim organit administrativ.

Neni 4

Objekti

Shoqëria ka për objekt aktivitetin e mëposhtëm:

- tregtimin, riparimin, qiradhënien, instalimin, prodhimin dhe përfaqësimin e materialit elektrik, elektronik, përçuesit elektrik, material radiofonik, informatik (komponent hardware dhe software), për telekomunikacion dhe për telefoninë celulare, për automatizimin e shtëpisë dhe për elektroshtëpiaket në përgjithësi, duke përfshirë materialin për sektorin e sigurimit të personave dhe të gjërave dhe parandalimin e aksidenteve, panele solare dhe aparatura për kursimin e energjisë elektrike, aparatura dhe materiale të sektorit hidro dhe termosanitar.
- magazinimin, krijimin, dhe ushtrimin e/ose menazhimin e magazinës, magazinim edhe për llogari të të tretëve të mallrave të të gjitha tipeve.
- transportim për vete ose për llogari të të tretëve, transportime dhe transferime si edhe të gjitha operimet e lidhura me transportin e mallrave dhe të materialeve pronë private, shoqëri tregtare dhe ente publike duke përfshirë punën e hamallit, logjistikë dhe lëvizje e mallrave

- organizimin e kurseve për formim profesional në sektorët e mësipërm (jo për qëllimin e futjes në punë, por për trajnimin e punëtorëve të cilat janë të punësuar ose për klientët).
- aktivitetin e E-Commerce të kryer për vete dhe për llogari të të tretëve.

Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare imobiliare dhe financiare të cilat do të konsiderohen të nevojshme nga organi administrativ për zbatimin e objektit të themelimit të shoqërisë, me përjashtim të aktivitetit financiar kundrejt publikut.

Shoqëria mund të marrë pjesë në unione, shoqata dhe bashkime shoqërisht të çdo lloji.

Neni 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë tregtare është caktuar deri më 31 (tridhjetë e një) Dhjetor 2050 (dymijë e pesëdhjetë)

Kapitali dhe kuotat

Neni 6

Kapitali

Kapitali i shoqërisë arrin shumën e 10.000,00 euro (dhjetë mijë) euro.

Sa herë që ligji e lejon, kuotat në kapitalin e shoqërisë mund t'u jepen ortakëve në masë joproportionale me kontributet e derdhura prej tyre.

Përveç rastit të përmendur në nenin 2482 të Kodit Civil, shtimi i kapitalit mund të arrihet edhe duke ofruar blerjen e kuotave të kapitalit themeltar të tretëve. Në këtë rast u takon ortakëve të cilët nuk kanë marrë pjesë në vendimmarrje, e drejta e dorëheqjes sipas nenit 2473 të Kodit Civil.

Asambleja, në respektim të parimit të barazisë ndërmjet ortakëve, mund të vendosi me shumicën e votave, zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë e cila parashikohet në nenin 14, përmes ndarjes së aseteve natyrore midis vet ortakëve ose grupeve të ortakëve.

Në rastin e zvogëlimit të kapitalit themeltar në më shumë se 1/3 për shkak të humbjeve, mund të lihet pa u depozituar dokumentacioni në selinë e shoqërisë në pritje të mbledhjes së asamblesë, siç parashikohet nga neni 2482 e vijues, pika e dytë e Kodit Civil.

Neni 7

Kontributet dhe financimet

Kontributet e ortakëve mund të kenë si objekt çdo element pronësie i cili lejohet nga ligji. Ortakët mund ta financojnë shoqërinë me pagesa fitimprurëse ose jofitimprurëse, me kapital ose me tituj të tjerë, edhe me detyrim shlyerje konform dispozitave ligjore në fuqi, me përjashtimin të parashikimeve të nenit 2467 të Kodit Civil.

Neni 8

Kuotat

Kuotat e shoqërisë tregtare përfaqësojnë një kuotë të kapitalit dhe janë të ndashme.

Vlera nominale e kuotave është e barabartë me kapitalin themeltar të shoqërisë i pjesëtuar me kuotën e përfaqësuar nga secili prej tyre.

Të drejtat që gëzon shoqëria i ushtrojnë ortakët në mënyrë proporcionale me kuotat që zotërojnë.

Në rastin e një tjetërsimi të pjesshëm ose të plotë të kuotave në shoqëri, ose të gëzimit të të njëjtave të drejta mbi to, i takon ortakëve të tjerë e drejta e parablerjes, e cila duhet të ushtrohet brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit e ortakut tjetërsues, e cila duhet të specifikojë përkatësisht emrin e blerësit të ardhshëm si dhe kushtet e tjera të tjetërsimit. Komunikimet e mësipërme duhet të kryhen me anë të letrës rekomande me njoftimin e marrjes së saj, e cila duhet ti dërgohet për të marrë dijeni edhe shoqërisë.

Parablerja duhet ushtrohet për të gjithë kuotat e ofruara.

Nëse më shumë ortak ushtrojnë të drejtën e parablerjes, kuotat e ofruara do të rindahen ndërmjet tyre në propocion me kuotat e zotëruara nga secili prej tyre dhe me të drejtën e zmadhimit të kuotave në favor të atyre ortakëve të cilët synojnë ta përdorin atë dhe të cilët nuk kanë refuzuar paraprakisht në mënyrë të shprehur ushtrimin e të drejtës së parablerjes e cila ju takon.

Nëse tjetërsimi ose ushtrimi i të drejtave të gëzimit mund të jetë falas dhe në përgjithësi në të gjitha rastet kur natyra e biznesit nuk parashikon një kundërvlerë ose kur kundërvlera nuk është në para, ortakët e tjerë kanë të drejtë të blejnë kuotat me çmimin e përcaktuar sipas nenit nr. 10.

Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar bëhet e mundur pa respektimin e formaliteteve të mësipërme nëse ortaku transferues i kuotave ka arritur të marrë vendimin e heqjes dorë nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes nga ana e të gjithë ortakëve të tjerë për atë pjesë specifike të shitjes.

E drejta e parablerjes gjithashtu nuk mund të ushtrohet në rast se transferimi i kuotave bëhet në ose nga shoqëritë e kredive të autorizuar për të ushtruar këtë veprimtari në përputhje me ligjin, në favor të përfaqësuesit fillestar.

3. Kuotat janë lirisht të transferueshme te trashëgimtarët në rast vdekjeje.

4. Dispozitat që bien në kundërshtim me rregullat e mësipërme janë të pavlefshme kundrejt shoqërisë.

5. Ndryshimet shuese dhe modifikuese të statutit aktual të paragrafëve 2, 3, 4, dhe 5 duhet të aprovohen me votë nga shumica e ortakëve të cilët përfaqësojnë të paktën 2/3 e kapitalit themeltar.

Neni 9

Dorëheqja e ortakëve

Ortakët kanë të drejtën të heqin dorë në rastet dhe sipas parashikimeve të ligjit.

Ortaku i cili parashikon të heqë dorë nga shoqëria duhet të njoftojë organin administrativ me anë të një letre rekomande.

Letra rekomande duhet të dërgohet brenda 30 ditësh nga regjistrimi në Regjistrin e shoqërive tregtare ose nëse nuk është parashikuar, nga transkriptimi i librit të vendimmarrjeve të ortakëve, të vendimit që legjitimon dorëheqjen, me të dhënat e ortakut që heq dorë dhe të adresës për komunikimet në lidhje me procedurën.

Nëse arsyeja që legjitimon dorëheqjen është i ndryshëm nga një vendim, kjo mund të ushtrohet jo më vonë se 30 ditë nga marrja dijeni e ortakut.

Organi administrativ është i detyruar ti komunikojë ortakëve rrethanat që mund të çojnë në ushtrimin e dorëheqjes brenda 15 ditëve duke filluar nga data nga e cila ka marrë dijeni. Dorëheqja konsiderohet e ushtruar ditën të cilën komunikimi është marrë nga selia e shoqërisë. Për ushtrimin e së drejtës së dorëheqjes duhet bërë shënimi në Regjistrin e shoqërive tregtare.

E drejta e dorëheqjes nuk mund të ushtrohet, edhe nëse është ushtruar, është i pavlefshëm nëse brenda 90 ditëve nga ushtrimi i të drejtës së dorëheqjes, shoqëria e revokon vendimin e legjitimitimit ose nëse është vendosur shpërbërja e shoqërisë.

Neni 10

Likujdimi i kuotave

Në hipotezën e parashikuar nga neni 9, kuotat do ti rimbursohen ortakut në proporcion me pronësinë në shoqëri.

Pronësia e shoqërisë vendoset nga organi administrativ, duke u dëgjuar mendimi i revizorit dhe auditit, nëse janë emëruar, duke u marrë parasysh vlera e tregut të kuotave në momentin e vlefshmërisë së dorëheqjes, i vendosur sipas nenit 9.

Në fund të përcaktimit të vlerës së tregut duhet të rishikohet qëndrueshmëria e pronësisë së shoqërisë dhe prespektiva e saj të të ardhurave.

Në rast mosmarrëveshjeje vlerësimi i kuotave sipas kriterëve të përshkruar më lart është e vlefshme përmes një raporti nga një ekspert kontabël i miratuar i emëruar nga gjykata në të cilën ndodhet selia e shoqërisë i cili parashikon edhe shpenzimet, me kërkesë të palës së interesuar. Në këtë rast aplikohet paragrafi i 1 i nenit 1349 të Kodit Civil. Rimbursimi i kuotave duhet kryer në mënyrën dhe afatet ligjore.

Asambleja dhe vendimmarrja e ortakëve

Neni 11

Thirrja

Thirrja e asamblesë bëhet nga organi administrativ me anë të një letre rekomande e dërguar të interesuarve të paktën 8 ditë përpara mbledhjes ose u dorëzohet në dorë duke u firmosur nga marrësit ose nëpërmjet faxit ose postës elektronike të certifikuar ose me

postë me vërtetim marrje në adresën e shoqërisë të regjistruar në Regjistrin e shoqërive tregtare.

Në lajmërimin e thirrjes mund të caktohet një ditë tjetër për thirrjen e dytë.

Asambleja e ortakëve mund të mbledhet edhe jashtë selisë e shoqërisë me kusht që të jetë brenda Italisë.

Asambleja për aprovimin e bilancit duhet të thirret të paktën një herë në vit brenda 120 ditëve nga mbyllja e vitit fiskal.

Për nevoja të veçanta por brenda afateve dhe kushteve të parashikuara nga neni 2364 i Kodit Civil, asambleja për aprovimin e bilancit mund të thirret brenda afatit më të gjatë të parashikuar nga ligji aktual.

Edhe në mungesë thirrjes formale, asambleja konsiderohet e mbledhur rregullisht kur në të merr pjesë i gjithë kapitali i shoqërisë dhe të gjithë administratorët dhe revizorët nëse janë caktuar, janë prezent dhe të informuar për mbledhjen dhe asnjë nuk e kundërshton shqyrtimin e çështjes. Në një rast të tillë nëse administratorët ose revizorët nëse janë caktuar, nuk marrin pjesë personalisht në asamble, duhet të lëshojnë një deklaratë të shkruar në të cilën deklarojnë se janë informuar për të gjitha çështjet e parashtruara në agjendën e ditës dhe se nuk kundërshtojnë shqyrtimin e tyre, e cila duhet të ruhet tek dokumentacioni i shoqërisë.

Nuk është i nevojshme vendimi i ortakëve, që autorizon blerjen nga shoqëria, me një vlerësim të barabartë ose më të madh se një e dhjeta e kapitalit aksionar, të aktiveve ose kredive të ortakëve themelues, të ortakëve dhe administratorëve, brenda dy viteve nga regjistrimi i shoqërisë në Regjistrin e shoqërive tregtare.

Neni 12

Ndërhyrja në votim

Kanë të drejtë për të ndërhyrë në asamble dhe janë përgjithësisht të legjitimuar për ushtrimin e të drejtave në shoqëri të gjithë ata që rezultojnë të regjistruar në Regjistrin përkatës të shoqërive tregtare.

Çdonjëri nga ortakët duke patur të drejtë të ndërhijë, mund të përfaqësohet edhe nga një jo ortak me anë të një prokure të shkruar.

Prokura e lëshuar për një mbledhje asambleje, është e vlefshme edhe për mbledhjen pasardhëse.

Pjesëmarrja nuk mund ti delegohet administratorëve, revizorëve ose auditëve edhe nëse janë caktuar.

Asambleja mund të mbledhet në vende të ndryshme, afër ose larg, me anë të audios dhe videos me kusht që të respektohet metoda kolegjiale dhe parimi i mirëbesimit dhe i barazisë së trajtimit të ortakëve, dhe në mënyrë të veçantë me kusht që: a) ti lejohet

Kryetari të asamblesë, edhe me anë të zyrës së vet të kryesisë të sigurohet për identitetin dhe legjitimitimin e të pranishmëve, të administrojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë dhe shpalli rezultatet e votimit; b) ti lejohe sekretares e cila mban procesverbalin të hedhë në procesverbal në mënyrë adekuate gjithë zhvillimin e mbledhjes; c) ti lejohe të pranishmëve të marrin pjesë në diskutim dhe në votimin e drejtpërdrejtë për çështjet e agjendës ditore të mbledhjes; d) të tregohen në njoftimin e mbledhjes (përveç në rastin e një mbledhje në të cilën merr pjesë i gjithë kapitali i shoqërisë në kuptimin e nenit 2479 e vijues të Kodit Civil, paragrafi i fundit) vendet e pajisura me audio dhe video nga shoqëria, në të cilat të pranishmit mund të zenë vendet, nga ku do të zhvillohet mbledhja, në të cilat do të jenë prezent kryetari dhe sekretaria e cila mban procesverbalin. E drejta e votës i takon ortakëve sipas parashikimeve në ligj.

Neni 13

Kryetari dhe procesverbali

Asambleja kryesohet nga administratori i vetëm ose nga kryetari i këshillit të administrimit (në rastin e emërimit të Këshillit të Administrimit) ose nga administratori më i moshuar (në rastin e emërimit të më shumë se një administratorë me kompetenca të ndara dhe të përbashkëta) ose në rastin e mungesës ose heqjes dorë të tyre, nga një person i caktuar nga vet Asambleja.

I takon Kryetarit të Asamblesë të verifikojë formimin e rregullt të saj, të verifikojë identitetin dhe legjitimitimin e të pranishmëve, të drejtojë dhe rregullojë zhvillimin e punës së Asamblesë dhe të verifikojë dhe shpalli rezultatet e votimeve, të cilat duhet të mbahen gjithmonë me votim të hapur.

Mbledhjet e Asamblesë fiksohen në një procesverbal të mbajtur nga sekretari, i caktuar nga vet Asambleja, dhe e nënshkruar nga vet ai si edhe nga kryetari.

Në rastin kur e parashikon ligji ose kur organi administrativ ose kryetari e konsiderojnë të domosdoshme, procesverbali redaktohet nga një noter. Në këtë rast asistimi i sekretarit nuk është i domosdoshëm.

Neni 14

Shumica

Vendimet e asamblesë si në mbledhjen e parë ashtu edhe në të dytën do të merren me votën e shumicës së kapitalit themeltar.

Megjithatë qëndrojnë të paprekura dispozitat e tjera ligjore ose të statutit aktual që për vendime të veçanta, kërkojnë shumicë më të madhe se kjo.

Administrimi dhe mbikëqyrja

Neni 15

Administratori

Shoqëria mund të administrohet ndryshe, nga vendimi i ortakëve në rastin e emërimit relativ : a) nga një administrator i vetëm, b) nga një këshill administrimi i përbërë nga 2 (dy) deri në 5 (pesë) anëtarë; c) nga dy ose më shumë administratorë me kompetenca të ndara ose të përbashkëta.

Me organ administrativ kuptohet, sipas rastit administratori i vetëm, këshilli i administrimit, ose bashkë me administratorët me kompetenca të ndara ose të përbashkëta.

Neni 16

Dispozitat e përbashkëta për administratorët

Administratorët mund të mos jenë ortakë, janë të rizgjedhshëm dhe i nënshtrohen ndalimit të konkurrencës në përputhje me nenin 2390 të Kodit Civil, përveç nëse kjo përjashtohet shprehimisht nga ortakët.

Administratorët caktohen për një periudhë të përcaktuar nga ortakët gjatë emërimit ose për një periudhë të pacaktuar.

Ata e lenë detyrën në rastet e parashikuara nga ligji ose nga statuti aktual.

Në rast e emërimit nga Këshilli i Administrimit , përveç siç parashikohet në paragrafin vijues, nëse gjatë ushtrimit të detyrës mungojnë një ose më shumë administratorë (me kusht që ata të mos përfaqësojnë gjysmën e administratorëve në rastin e një numri çift ose të shumicës së tyre, në rast të një numri tek), të tjerët i zëvendësojnë ata; administratorët e emëruar kështu qëndrojnë në detyrë deri në mbledhjen e ardhshme.

Nëse për ndonjë arsye më shumë se gjysma ekëshillëtarëve mungon, në rastin e një numri çift, ose shumica e të njëjtëve në rastin e një numri tek, zbatohet neni 2386 i Kodit Civil Italian.

Nëse emërohet një këshill i përbërë nga dy administratorë, nëse ata nuk pajtohen me revokimin e mundshëm të kompetencave të dhëna njërit prej tyre, të dy do të lënë detyrën e tyre dhe pa hezitim duhet t'u paraqesin ortakëve vendimin për emërimin e një organi të ri administrativ.

Në rast të emërimit të më shumë administratorëve, revokimi ose dorëheqja e njërit prej tyre nuk përcakton lënien e detyrës për të tjerët.

Administratorët kanë të drejtë e imbursimit të shpenzimeve të bëra për arsye të detyrës së tyre.

Ortakët gjithashtu mund t'u caktojnë administratorëve një "kompensim fiks vjetor, ose një kompensim proporcional me fitimet neto të vitit, si dhe të përcaktojnë një kompensim për përfundimin e detyrës dhe të miratojnë alokimin e fondit përkatës për pensionin me metodat e vendosura me vendim të ortakëve.

Në rast të emërimit të një komiteti ekzekutiv ose këshilltar të deleguar, shpërblimi i tyre përcaktohet nga këshilli i administrimit në momentin e emërimit, pas këshillimit me organin mbikëqyrës, nëse është caktuar.

Neni 17

Administratori i vetëm

Administratorit të vetëm i takojnë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, pa asnjë limit, përveç kur përjashtohet detyrimisht nga ligji.

Neni 18

Këshilli administrues

Nëse ortakët nuk e kanë bërë këtë në kohën e emërimit, këshilli administrues zgjedh një kryetar nga radhët e anëtarëve të tij.

Kryetari thërret këshilli administrues, përcakton axhendën, koordinon punën dhe sigurohet që të gjithë administratorët të informohen në mënyrë adekuate për çështjet që do të trajtohen.

Thirrja bëhet me anë të një njoftimi dërguar të gjithë administratorëve dhe auditëve të përhershëm, nëse janë emëruar, me çdo mjet të përshtatshëm për të siguruar provën e marrjes, të paktën tre ditë para mbledhjes dhe, në rast urgjence, të paktën dy ditë para.

Data, vendi dhe ora e mbledhjes, si dhe rendi i ditës, përcaktohen në njoftim.

Këshilli mbledhet në selinë e shoqërisë ose edhe diku tjetër, për atë kohë sa është në Itali.

Mbledhjet e këshillit dhe vendimet e tij janë të vlefshme, edhe pa thirrje zyrtare, kur marrin pjesë të gjithë anëtarët dhe auditët e përhershëm, nëse janë emëruar.

Mbledhjet e këshillit administrues gjithashtu mund të kryhen me konferencë audio ose video-konferencë, me sigurinë dhe metodat e parashikuara në lidhje me këtë në asamblenë e ortakëve.

Për vlefshmërinë e vendimeve të këshillit administrues, të marra në të njëjtën mbledhje kërkoher praninë e shumicës së anëtarëve të tij në detyrë; vendimet merren me shumicën absolute të votave të të pranishmëve.

Në rast barazimi votash, propozimi konsiderohet i refuzuar.

Për vendimet e mbledhjes do të hartohet një procesverbal i firmosur nga kryetari dhe nga sekretari nëse është emëruar, të cilat duhet të transkriptohen në librin e vendimeve të administratorëve.

Vendimet e këshillit administrues, brenda kufijve të përcaktuar me ligj, mund të merren gjithashtu me anë të konsultimit me shkrim, ose në bazë të aprovimit të shprehur me shkrim, me kusht që: a) secilit administrator t'i sigurohet e drejta për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe tu sigurohet informacioni i duhur të gjithë atyre që kanë të drejtë ta marrin; b) nga dokumentet e nënshkruara nga administratorët të rezultojë qartësisht

çështja objekt i vendimit dhe aprovimi për të; c) vendimet të transkriptohen pa vonesë në librin e vendimeve të administratorëve dhe të ruhet në aktet e shoqërisë dokumentacioni përkatës; d) ti jepet të paktën një administratori e drejta për të kërkuar marrjen e një vendimi në një mbledhje kolegjiale; e) të marri votën në favor nga shumica e administratorëve në detyrë.

Këshilli administrues ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, pa asnjë kufizim, përveç se asaj që nuk lejohet me ligj.

Këshilli administrues mund të delegojë, brenda kufijve të përcaktuar me ligj, siç referohet më poshtë, kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, ose një pjesë të tyre, te një ose më shumë administratorë të deleguar, si dhe një komiteti ekzekutiv.

Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen nga ky statut në lidhje me këshillin administrues, zbatohen rregullat e përcaktuara në lidhje me shoqëritë aksionare, për atë sa ato janë në përputhje.

Neni 19

Administratorët e veçantë dhe të përbashkët

Në rast të emërimit të më shumë administratorëve, pa u formuar një këshill administrimi, atyre u takojnë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, pa asnjë kufizim, përveç asaj që kufizohet me ligj.

Vendimi i emërimit vendos nëse kompetenca të caktuara i takojnë tërësisht apo pjesërisht, veçmas apo bashkërisht të gjithëve, bashkarisht midis dy ose më shumë administratorëve, me shumicë apo në të kundërt, përveç sa parashikohet në nenin 2475, paragrafi i pestë, i Kodit Civil.

Konsiderohen në përputhje me parashikimet e dispozitave të nenit 18.

Nëse nga vendimi i emërimit nuk është e qartë nëse kompetencat për të kryer një lloj të caktuar veprimesh i takon administratorëve veç e veç, apo bashkërisht, duhet të kuptohet se i përket të gjithë administratorëve bashkërisht.

Në rastin e administrimit të përbashkët, administratorët individualë nuk mund të kryejnë asnjë veprim, përveç në rastet kur është e nevojshme të veprohet urgjentisht për të shmangur një dëm në shoqëri.

Nëse administrimi u besohet veç e veç disa administratorëve, në rast të kundërshtimit të një administratori për veprimet që parashikon të kryej një tjetër administrator, për kundërshtimin vendosin të gjithë administratorët me shumicën votash.

Neni 20

Përfaqësimi

Përfaqësimi i shoqërisë i takon sipas rastit: a) administratorit të vetëm; b) kryetarit të këshillit administrues, zëvendëskryetarit ose anëtarëve të deleguar, nëse janë emëruar, veç e veç midis tyre dhe kryetarit të këshillit ekzekutiv brenda kufijve të kompetencave të dhëna atyre; c) administratorëve veç e veç ose bashkarisht, sipas së njëjtës mënyrë që ju janë dhënë kompetencat e administrimit.

Përfaqësimi i shoqërive në proces falimentimi i takon administratorit të falimentimit ose kryetarit të këshillit të falimentimit sipas mënyrës dhe kufijve të përcaktuar në emërim.

Përfaqësimi i shoqërisë i takon edhe drejtorëve, drejtorit ekzekutiv dhe përfaqësuesit ligjor, brenda kufijve të kompetencave që ju janë dhënë atyre nga akti i emërimit.

Drejtori, administratori i vetëm, çdo anëtarët, administratorët të cilët nuk themelojnë një këshill administrimi ose organin përgjegjës për falimentimin, brenda kompetencave të tyre mund të caktojnë një përfaqësues ligjor dhe një të autorizuar për të kryer veprime ose kategori veprimesh edhe me cilësinë e përfaqësuesit të përfaqësuesit ligjor.

Neni 21

Organi mbikëqyrës dhe auditimi ligjor

Organi mbikëqyrës, auditit dhe shoqëria e auditimit janë emëruar dhe funksionojnë sipas ligjit.

Megjithatë shoqëria mund të caktoj një bord auditimi si alternativë e auditit të vetëm.

Organi mbikëqyrës kryen auditimin ligjor të llogarive, me përjashtim të rasteve kur është e detyrueshme emërimi i një auditit ligjor ose të një shoqërie auditimi ose shoqëria vendos vullnetarisht në emërimin e auditit ligjor ose të shoqërisë së auditimit.

Nëse, si një alternativë ndaj organit mbikëqyrës dhe duke përjashtuar rastet e natyrës të detyrueshme, shoqëria emëron një auditor ligjor ose një shoqëri auditimi për auditimin ligjor të llogarive, këto duhet të regjistrohen në regjistrin përkatës. Në këto raste aplikohen të gjitha dispozitat e parashikuara edhe për shoqëritë aksionare si dhe legjislacioni i veçantë.

Mbledhja e këshillit të auditimit mund të mbahen edhe nëpërmjet mjeteve të telekomunikacionit, me sigurinë dhe mënyrën e përcaktuar në asamblenë e ortakëve.

Bilanci-Të ardhurat-Falimentimi

Neni 22

Viti financiar dhe bilanci

Viti financiar mbyllet në 31 (tridhjetë e një) Dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo viti financiar, organi administrativ përgatit pasqyrat financiare konform ligjit.

Neni 23

Të ardhurat dhe dividendët

Të ardhurat neto që rezultojnë nga pasqyrat financiare të miratuara, pasi të zbritet pjesa e destinuar për rezervën ligjore derisa kjo të ketë arritur një të pestën e kapitalit, mund të caktohen për rezervën ose t'u shpërndahen ortakëve, sipas asaj që ata kanë vendosur.

Neni 24

Falimentimi

Nëse shoqëria në çdo kohë dhe për çdo arsye rrezikon të falimentojë, asambleja përcakton procedurat dhe kriteret për likuidim dhe do të emërojë një ose më shumë administratorë falimentimi, duke përcaktuar dhe kompetencat e tyre.

Neni 25

Klauzolë e arbitrazhit

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis ortakëve ose midis ortakëve dhe shoqërisë që ka si objekt të drejtat me natyrë civile, me përjashtim të atyre në të cilat ligji parashikon ndërhyrjen e detyrueshme të prokurorit publik, duhet të zgjidhet me arbitrazh në përputhje me rregulloren e Dhomës Kombëtar dhe Ndërkombëtar të Arbitrazhit të Milanos.

Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga një arbitër i vetëm, i caktuar nga Dhoma e Arbitrazhit.

Arbitri do të vendosë në mënyrë rituale dhe sipas të drejtës.

Është vendosur në mënyrë të parevokueshme që zgjidhjet dhe vendimet e arbitrit janë detyruese për palët.

Arbitri do të përcaktojë se si do të ndahen kostot e procesit së arbitrazhit midis palëve.

Janë objekt i disiplinës së parashikuar më sipër edhe mosmarrëveshjet e nxitura nga drejtorët, likuiduesit dhe auditorët ligjorë, ose ato të ngritura kundër tyre, të cilat kanë si objekt të drejtat me natyrë civile..

Për çdo gjë që nuk është parashikuar, zbatohen dispozitat e ligjit material.

Ndëryshimet në aktin e themelimit që shfuqizojnë këtë klauzolë të arbitrazhit duhet të miratohet me vendim të ortakëve, me një shumicë votash prej të paktën dy të tretave të kapitalit themeltar. Ortakët që mungojnë ose që nuk janë dakort mund të ushtrojnë të drejtën e dorëheqjes, brenda nëntëdhjetë ditëve në vijim, në përputhje me nenin 9.

Neni 26

Klauzola e fundit

Do të aplikohen dispozitat e ligjit material, nëse nuk është shprehimisht e parashikuar ndryshe.

F.to Marco Falcone

Stefano Maruzzella

Alessandra Sanfelici

Pulla e paguar në zbatim të dekretit 22/02/2007 Mediante M.U.I

Kopja e shkruar elektronikisht është e njëjtë me kopjen origjinale të dokumentit të përpiluar në letër, në zbatim të nenit 23 të D.Lgs 7 Mars 2005 nr. 82, që transmetohet për përdorim nga Regjistri i shoqërive Tregtare.



Regjistri i shoqërive tregtare
Arkivi kombëtar i dokumentave

Dhoma e Tregtisë Industrisë Artizanatit dhe Agrikulturës së Cagliari -Oristano

Në bazë të nenit 24 DPR 581/95 lëshohet kopja e dokumentit, e protokolluar në Regjistrin e shoqërive tregtare MI/RI/PRA/2012/000007079 në dt. 12/01/2012 dhe vërtetohet origjinaliteti sipas regjistrimit të kryer në arkivin informatik të Regjistrit të shoqërive tregtare.

Nr. Faqeve të kopjes: 14

Cagliari, 12/01.2021



Arkivisti
Fedele Annis
(Asistent Amministrativ)

Prefektura e Cagliariit
Zyra administrative shtetërore
Zona IV - Të drejtat civile, Shtetësia dhe Emigrimi

Vula apostile
(Konventa e Hagës e 5 tetorit 1961)

9. Shteti Italia

Shkresa e mësipërme zyrtare

10. Është firmosur nga Luisella Marcias

11. Punonjëse me cilësinë e Nëpunëse e deleguar

12. E pajisur me vulën e Dhomës së Tregtisë Cagliari-Oristano

13. Në Cagliari 6. Më 19/01/2021

14. Nga Prefektura e Cagliari

15. Me nr. 32

16. Vula

Firma

Asistent administrative

(Maria Luisa Orbana)

Korrispondenca e bashkëlidhur, drejtuar Prefekturës së Cagliari, duhet të përcillet në adresën e postës elektronike të certifikuar: cittadinanza.prefca@pec.interno.it

Ky dokument është përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, në përputhje me tekstin origjinal nga **Irida Kroni**

Irida Kroni
IRIDA KRONI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER GJERGJ R. KONGOLI**



**DATE 01/02/2021
NR REP 549**

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 01.02.2021, para meje Noter GJERGJ R. KONGOLI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 10, RR. KONT URANI, GODINA NR. 3 , u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Irida Kroni, atësia Azem, amësia Ylvije, shtetase Shqiptare, lindur në Shkodër, Shkodër dhe banues në TIRANË, me adresë Rr.'abaz Ermenji' Nd.61 Shk.1 Ap.11, lindur më 26/03/1982, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 029872443 dhe nr. personal I25326162U , .

Përkthyesja më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur nga gjuha Italiane në gjuhën Shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"; në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

GJERGJ R. KONGOLI

